

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6924  
E shtunë, 17 qershor 2023  
Çmimi 0.40 €

## Gazeta gjermane 'FAZ' për Kurtin: Kokëfortë në dëm të vendit të vet

FAQE 3



Halsstarrig zum Schaden des eigenen Landes

Albin Kurti hat die Unterstützung des Westens für das Kosovo für Erste verspielt. Er hat nicht verstanden, wie wichtig Ruhe auf dem Balkan für den Westen angesichts von Russlands Angriff auf die Ukraine ist.

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

EMISARI GABRIEL ESCOBAR KA MBAJTUR TË PREMTEN  
NJË KONFERENCË ONLINE PËR MEDIE | FAQE 4-5

## ESCOBARI: ATA QË REFUZOJNË PARTNERITETIN DO TË KENË PASOJA



I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë të premtën se Kosova do të përballet me pasoja nëse vazhdon ta injorojë këshillën e Shteteve të Bashkuara - që kryetarët e rinj shqiptarë të mos punojnë në

ndërtesat komunale në veri. Ai ka thënë në një konferencë online për medie se gjithçka që ka bërë ShBA-ja në 90 ditët e fundit, ka qenë në favor të Kosovës. "Ata që duan të jenë partnerë me ne, duhet të punojnë afër me ShBA-në

dhe Bashkimin Evropian, në pikat në të cilat jemi duke insistuar. Një lider nuk mund të ketë në dorë drejtimin e gjithë rajonit. Prandaj, ata që refuzojnë partneritetin do të kenë pasoja", ka deklaruar Escobari

### OPINION

KUSH PO E TRADHTON  
INTERESIN SHTETËROR  
DHE INTERESIN KOMBËTAR F. 6

Milazim  
KRASNIQI



### AKTUALE



PARABURGIM PËR TRE POLICËT,  
SERBIA DYSHON NË "POSEDIM TË  
PALIGJSHËM ARMËSH" F. 5

MARRËDHËNIE SEKSUALE NË ZYRË,  
JEP DORËHEQJE KRYEBASHKIAKU I  
KUKËSIT F. 7

### EKONOMI



GËRXHALIU: DIALOGU ME  
PARTNERITETIN NDËRKOMBËTAR,  
I PAZËVENDËSUESHËM  
PËR TË ARDHMEN E KOSOVËS F. 8

AVOKATI I POPULLIT DHE  
PËRFAQËSUES TË UN WOMEN  
KOSOVO VIZITOJNË KEDS-in F. 8

### SPORT



NORA CJAKOVA, E ARGJENDTË  
NË KAZAKISTAN F. 10

**RAMA:  
MARRËVESHJA  
KOSOVË - SERBI  
NUK DO TË JETË  
PËRGJITHMONË  
NË TRYEZË**



**REAGIME TË  
SHUMTA NË  
PËRKRAHJE TË  
"KLAN KOSOVËS"  
DHE KUNDËR  
VENDIMIT TË MINT**



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Orbani vjen në Shqipëri, nënshkruan disa marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, ndodhet në Shqipëri në një vizitë zyrtare. Ai është prituri të premtën me ceremoni shtetërore nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Orbani është i shoqëruar nga ministri i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë, Peter Szillarto dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Marton Nagy.

Të dyja palët kanë nënshkruar disa marrëveshje, ndër to edhe Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Hungarisë për zhvillimin e një bashkëpunimi më të madh në fushën e Integritimit Evropian, si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit për bashkëpunim në fushën e menaxhimit të ujit ndërmjet Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore të Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Hungarisë.

Kryeministri shqiptar, Edi Rama, dhe homologu i tij hungarez, Viktor Orban, më pas kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për gazetarët. Orban kritikoi BE-në në lidhje

me zvarritjen e procesit të integritimit. Sipas tij, BE-ja nuk e ka kuptuar ende rëndësinë e Ballkanit Perëndimor.

“Konkurenti i Evropës është në rënie dhe çështja është si mund ta konsiderojmë integritimin e Ballkanit në BE. Është një problem apo një mundësi? Nëse Evropa nuk do të mbetet pas në zhvillimin botëror, rezervat e rritjes ekonomike janë në Ballkan dhe nuk gjenden në asnjë rajon tjetër të Evropës. Për këtë arsye kërkojmë që Shqipëria të anëtarësohet. Sa i përket BE-së, është e turpshme dhe e papranueshme se sa ngadalë po ecën zgjerimi i saj”, tha Orban, duke theksuar se Shqipërisë i janë dashur 13 vjet që ta marrë statusin e vendit kandidat. “Nuk kam bindjen e patundshme se politika e zgjerimit është diçka e mirë. Duhet parë perspektivat e reja. Por, jemi të përkushtuar që Shqipëria të anëtarësohet në BE dhe ky proces duhet përshpejtuar. Kam mbështetur nismat e kryeministrit Edi Rama”, u shpreh Orban.

Ai theksoi se mbështetja financiare e BE-së për Ballkanin është shumë e ulët krahasuar me fondet që jepen për vendet e tjera. “Nuk duhet prituri formalizimi i



anëtarësimit për ta lehtësuar veprimtarinë e një vendi për t'u futur në këtë hapësirë. BE-ja nuk është në gjendje të mirë sot. Do të paguajë një çmim të lartë nëse nuk e pranon Ballkanin [Perëndimor]”, theksoi Orban në Tiranë.

Ai foli edhe për mundësinë e shtimit të investimeve hungareze. Kompanitë hungareze do të jenë gjithnjë respektuese të ligjit, tha

Orban, duke garantuar shtim të investimeve dhe thellim të bashkëpunimit mes dy vendeve. “Turizmi përbën 15 për qind të prodhimit të brendshëm bruto, edhe pse nuk kemi det, ndaj jemi gati ta japim ekspertizën tonë për këtë sektor. Gjithashtu, duam të shtrihemi në sektorin bankar, energjetik, të menaxhimit të ujit”, shtoi ia. Kryeministri Edi Rama tha se

falë homologut të tij hungarez, Viktor Orban, marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve kanë hyrë në një fazë të re. “Duam të kemi më shumë kompani hungareze, kemi folur për të sjellë më shumë ekspertizë dhe investime në fushën e energjisë dhe të turizmit. Turistët nga Hungaria janë shtuar çdo vit”, theksoi Rama në konferencën e përbashkët për medie.

## NATO-ja shqyrton mënyrat për t'i forcuar lidhjet me Ukrainën

BRUKSEL, 16 QERSHOR - Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s u mbledhën të enjten për të diskutuar për marrëdhëniet me Kievin zyrtar dhe se si do të veprohet në të ardhmen, pasi lufta e Rusisë kundër Ukrainës pengon aspiratat e saj për t'iu bashkuar së shpejti Aleancës më të madhe të sigurisë në botë.

Ministrat kanë planifikuar të marrin pjesë në një mbledhje shtesë në selinë e NATO-s, të njohur si Grupi i Kontaktit në Ukrainë, i udhëhequr nga ShBA-ja.

Ky forum frekuentohet në mënyrë rutinore nga aleatët e Ukrainës në një përpjekje për të siguruar burime ushtarake, si armë dhe municione për ta ndihmuar Kievin në luftimin e pushtimit rus. Takimi i NATO-s realizohet një muaj përpara se presidenti amerikan Joe Biden dhe homologët e tij të mbledhen për një samit në Lituani, në një paraqitje simbolike të mbështetjes për Ukrainën.

Ata pritet ta nënvizojnë vendosmërinë e tyre për të vepruar nëse presidenti rus Vladimir Putin përpiqet ta zgjerojë luftën drejt Perëndimit.

NATO-ja ra dakord në vitin 2008



që Ukraina do t'i bashkohej organizatës një ditë, por nuk caktoi një datë që ajo të fillonte bisedimet e anëtarësimit. Pas fillimit të luftës, Ukraina aplikoi për “aderim të përshpejtuar” në NATO, më 30 shtator. Me gadishullin e Krimesë të aneksuar dhe trupat ruse dhe separatistët pro-Moskës që mbajnë pjesë të jugut dhe lindjes, nuk është e qartë

se si do të duken kufijtë e Ukrainës në të ardhmen.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se nuk ka konsensus për anëtarësimin e vendit përderisa është në luftë me Rusinë. “Ne pajtohemi se detyra më urgjente tani është të sigurohemi që Ukraina të mbizotërojë si një komb sovran i pavarur, sepse nëse Ukraina nuk

mbizotëron dhe mund të vazhdojë si një shtet demokratik në Evropë, nuk ka asnjë çështje anëtarësimi për t'u diskutuar”, tha ai përpara takimit.

Stoltenbergu tha se ai pret që Aleanca prej 31-vendesh “të bjerë dakord për një program shumëvjeçar ku ne ndihmojmë për ta lëvizur Ukrainën në kalimin nga standardet, pajisjet,

procedurat, doktrinat e vjetra në standardet e NATO-s, dhe të bëhet plotësisht e ndërveprueshme me NATO-n”.

NATO-ja nuk ka prani zyrtare në Ukrainë dhe si organizatë ofron vetëm mbështetje jovdekjeprurëse për Kievin, megjithëse aleatët individualisht e furnizojnë me armë dhe municione.



# Rama: Marrëveshja Kosovë - Serbi nuk do të jetë përgjithmonë në tryezë

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se lirimi i tre pjesëtarëve të Policisë së Kosovës të arrestuar nga forcat serbe në veri të vendit duhet të bëhet menjëherëshme, teksa shtoi se "Kosova duhet ta kapë mundësinë e artë që po i ofrohet nga ndërkombëtarët".

Në konferencën e përbashkët për medie me homologun hungarez Viktor Orban, Rama tha se Shqipëria po përdor "të gjitha kanalet e mundshme" për ta siguruar lirimin e policëve të Kosovës.

Kosova e konsideron arrestimin e tre zyrtarëve policorë si rrëmbim nga autoritetet e Serbisë në

territorin e saj. Sipas Policisë së Kosovës, zyrtarët policorë janë arrestuar në Tresave/Bare që gjendet në komunën e Leposaviqit, brenda territorit të Kosovës. "Përtej faktit se ku janë kapur dhe si janë kapur, ata duhen liruuar menjëherë. Ne po i përdorim të gjitha kanalet e mundshme që kjo të ndodhë sa më parë. Edhe nëse kanë kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme, ata sërish duheshin liruuar", tha kryeministri shqiptar. Sipas tij, zgjidhja e krizës në veri të Kosovës vjen vetëm përmes dialogut. "Paqja është në tryezë, dokumenti i marrëveshjes është aty dhe mundësia historike është në tryezë, për të mbyllur një kapitull

të gjatë e të dhimbshëm e për të hapur një kapitull të ri e për ta bërë Kosovën të njohur ndërkombëtarisht, edhe nga Serbia", u shpreh Rama.

Rama nënvizoi se marrëveshja drejt normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë që është vënë "në tryezën e Kosovës" nga bashkësia ndërkombëtare është një "mundësi të artë", dhe vetëm aty duhet të jetë fokusi. "E them me plot gojën se ajo marrëveshje dhe kjo mundësi e artë nuk mund të jetë aty përgjithmonë. Pastaj hyjmë në një tjetër kohë të gjatë në histori, ku mund të mos ketë zgjidhje", u shpreh Rama, duke thënë se është 100 % i fokusuar te

kjo zgjidhje.


"Të tjerat mund të jenë pilula ekzaltimi për ata që e shohin veten si patriotë në luftëra imagjinare, por nuk sjellin asgjë veç humbjes së kohës dhe të mundësisë", tha ai. Kryeministri shqiptar ua ka përcjellë një draft për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë presidentit të Francës, Emmanuel Macron, dhe kancelarit gjerman Olaf Scholz.

Rama tha se dokumenti është konfidencial, por u shpreh i bindur se është "një dokument i nivelit më të lartë ndërkombëtar që merr në konsideratë të gjitha arsyet për krijimin e Asociacionit dhe që Asociacioni është pjesë e

organizimit të jetës për Kosovën".

Që nga tensionimi i situatës në pjesën veriore të Kosovës, në fund të majit, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka mbajtur qëndrim kritik në raport me veprimet e institucioneve të Kosovës.

Mospajtimi i Ramës, sidomos me përgjigjen që kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka në raport me kërkesat ndërkombëtare për shtensionimin e situatës në veri, ka çuar në anulimin e një mbledhjeje të përbashkët të qeverisë së Kosovës dhe të Shqipërisë, e paraparë të mbahej më 14 qershor në qytetin e Gjakovës. Këto zhvillime shihen si pikë e ulët në raportet ndërshtetërore Kosovë - Shqipëri.



## Gazeta gjermane 'FAZ' për Kurtin: Kokëfortë në dëm të vendit të vet

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka një histori të gjatë konfrontimi me aleatët perëndimorë të vendit të tij, shkruan në një artikull gazeta gjermane "Frankfurter Allgemeine Zeitung".

"Ai dikur udhëhoqi protesta kundër misionit të OKB-së në Kosovë dhe kundër planit të paqes të OKB-së për konfliktin me Serbinë. Që në fillim, ai kundërshtoi marrëveshjet me të cilat BE donte t'i normalizonte marrëdhëniet midis Serbisë dhe ish-krajinës së saj dhjetë vjet më parë. Pra, ai është konsistent në sabotimin e zbatimit të tyre si kreu i qeverisë. Nëse e doje mirë Kurtin, mund ta quash këtë qëndrim drejtësi. Në realitet, megjithatë, është një kokëfortësi me të cilën ai po e dëmton vendin e tij - ndoshta

përgjithmonë", shkruan kjo gazetë.

Në këtë artikull shkruhet se Kurti e ka shfrytëzuar me bixhoz mbështetjen e ShBA-së dhe të BE-së për Kosovën. "Brukseli dhe Uashingtoni tani e konsiderojnë Kosovën si problematike në Ballkan, jo Serbinë. Dhe kjo përkundër faktit se Beogradi nuk e ka ndryshuar qëndrimin pengues me të cilin gjithmonë ka penguar zgjidhjen e konfliktit. Me sa duket Kurti nuk e ka kuptuar se sa e rëndësishme është qetësia në Ballkan për Perëndimin përballë luftës së agresionit rus në Ukrainë. Politikani cinik i pushtetit, Aleksandër Vuçiq, është i një kalibri tjetër në Beograd. Ai drejton propagandën pro-ruse për përdorim të brendshëm - dhe furnizon Ukrainën me armë", shkruan FAZ.

KOSOVOS REGIERUNGSCHEF

### Halsstarrig zum Schaden des eigenen Landes

EIN KOMMENTAR VON REINHARD VESER - AKTUALISIERT AM 15.06.2023 - 18:19

Albin Kurti hat die Unterstützung des Westens für das Kosovo fürs Erste verspielt. Er hat nicht verstanden, wie wichtig Ruhe auf dem Balkan für den Westen angesichts von Russlands Angriff auf die Ukraine ist.





EMISARI GABRIEL ESCOBAR KA MBAJTUR TË PREMTEN NJË KONFERENCË ONLINE PËR MEDIE

# Escobari: Ata që refuzojnë partneritetin do të kenë pasoja

I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë të premten se Kosova do të përballet me pasoja nëse vazhdon ta injorojë këshillën e Shteteve të Bashkuara - që kryetarët e rinj shqiptarë të mos punojnë në ndërtesat komunale në veri. Ai ka thënë në një konferencë online për medie se gjithçka që ka bërë ShBA-ja në 90 ditët e fundit, ka qenë në favor të Kosovës. “Ata që duan të jenë partnerë me ne, duhet të punojnë afër me ShBA-në dhe Bashkimin Evropian, në pikat në të cilat jemi duke insistuar. Një lider nuk mund të ketë në dorë drejtimin e gjithë rajonit. Prandaj, ata që refuzojnë partneritetin do të kenë pasoja”, ka deklaruar Escobari

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHITINË, 16 QERSHOR - I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se Kosova do të përballet me pasoja nëse vazhdon ta injorojë këshillën e Shteteve të Bashkuara - që kryetarët e rinj shqiptarë të mos punojnë në ndërtesat komunale në veri. Ai ka thënë në një konferencë online për medie se gjithçka që ka bërë ShBA-ja në 90 ditët e fundit, ka qenë në favor të Kosovës. “Serbia nuk ka dashur të shkojë përpara aplikimi i Kosovës në Këshillin e Evropës. Ne e kemi mbështetur. Serbia ka dashur që Kosova t’i anulohet zgjedhjet, por ne i kemi mbështetur. Serbia ka dashur që zgjedhjet të shpallen të

paligjshme për shkak të daljes së ulët. Ne i kemi mbështetur ato. Serbia nuk ka dashur të njihet legjitimiteti i kryetarëve të rinj. Ne i kemi njohur ata. Dhe e sfidoj gjithsecilin që të gjejë diçka që ne kemi bërë e që nuk ka shkuar në të mirë të Kosovës”, ka deklaruar zyrtari i lartë amerikan. Escobari ka thënë se ambasadorët amerikanë në Kosovë dhe Serbi nuk e kanë përmendur kurrë fjalën sanksion, por pasoja. “Ata që duan të jenë partnerë me ne duhet të punojnë afër me ShBA-në dhe Bashkimin Evropian, në pikat në të cilat jemi duke insistuar. Një lider nuk mund të ketë në dorë drejtimin e gjithë rajonit. Prandaj, ata që refuzojnë partneritetin do të kenë pasoja”. Sipas tij, përshkallëzimi është

duke krijuar kushte të vështira për rajonin, dhe jo vetëm për Kosovën dhe Serbinë, prandaj të dyja palët kanë rol në uljen e tensioneve. Komuniteti ndërkombëtar i ka drejtuar tri kërkesa kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, lidhur me situatën në veri: shtensionimin e situatës atje, mbajtjen e zgjedhjeve të reja, kthimin në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. I pyetur nëse do të marrë pjesë në takimin që do të mund të mbahet në Bruksel javën e ardhshme në mes të Kosovës dhe Serbisë, nën organizim të kryediplomatit evropian Josep Borell, Escobari ka thënë se ende është duke u punuar në takim. “Varësisht prej

përgatitjeve që do të kemi, do të vendosim nëse do të shkoj në Bruksel. Por, pa asnjë dyshim, këto përpjekje do ta kenë mbështetjen amerikane”. Escobari ka thënë se beson që Qeveria e Kosovës duhet ta heqë ndalesën ndaj mallrave serbe në kufi. “BE-ja beson se diçka e tillë jo vetëm që është joevropiane, po as nuk ekziston bazë ligjore. Ne e mbështetim këtë qëndrim dhe besojmë se është përshkallëzim i panevojshëm i një situatë veçse të tensionuar”, ka deklaruar Escobari. Emisari i ShBA-së, Gabriel Escobar, ka thënë se janë duke e ndjekur me kujdes rastin e tre policëve të Kosovës. “Po e ndjekim rastin e tre policëve të arrestuar me shumë kujdes. Ne do të kemi një qëndrim kur t’i kemi faktet e plota. Tani janë dy skenarë të mundshëm: që ata janë marrë nga territori i Kosovës dhe janë dërguar në Serbi; i dyti ata e kanë kaluar kufirin pa dashur dhe e kanë gjetur veten në territorin e Serbisë. Por është e qartë që këta policë s’kanë pasur synim për të qenë në Serbi dhe duhet të lirohen”, ka thënë Escobari.

Për Asociacionin, Escobari: Nuk po i kërkojmë Kosovës të bëjë

diçka që nuk duhet të bëjë

Escobari ka thënë se çështja e formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe përbën detyrim ligjor për Kosovën. “Duke e refuzuar këtë obligim, Kosova po refuzon rrugën evropiane, se ky obligim lidhet me Kosovën dhe Serbinë, por edhe me Kosovën dhe BE-në. Ne nuk po i kërkojmë Kosovës të bëjë diçka që nuk duhet të bëjë. Ne po themi që do t’i ndihmojmë që [Asociacioni] të hartohet sipas kornizës së politikave evropiane”. Prandaj, Escobari ka thënë se nuk e kupton refuzimin e Qeverisë së Kosovës për këtë temë. “E kemi dëgjuar disa herë kryeministrin që ka thënë se vetëm po e zbaton ligjin, por sundimi i ligjit nënkupton dhe pranimin e obligimeve ndërkombëtare. Nëse flasim për sundim të ligjit, Asociacioni është pjesë e tij”, ka thënë Escobari.

**Kurti: Ende nuk kam vendosur se a do të shkoj në Bruksel**

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ende nuk ka vendosur se a do të shkojë në



# Paraburgim për tre policët, Serbia dyshon në “posedim të paligjshëm armësh”

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Prokuroria e Lartë Publike në Kralëvë - qytet në jug të Serbisë - dha urdhër për kryerjen e hetimeve ndaj tre policëve të Kosovës, të arrestuar nga forcat serbe më 14 qershor. Sipas autoriteteve serbe, ata dyshohet se kanë kryer veprën penale: prodhim, posedim, mbajtje dhe trafikim i paligjshëm i armëve dhe lëndëve plasëse, e cila bart dënimin deri në 12 vjet burgim.

Tre policëve, B. S., R. Z. dhe M. Sh., iu shqiptua të premtën masa e paraburgimit nga gjyqtari i procedurës paraprake në Gjykatën e Lartë në Kralëvë, por tash për tash nuk është e qartë

kohëzgjatja e saj.

Qeveria e Kosovës pretendon se policët janë “rrembyer” pasi, sipas saj, ata janë arrestuar në territorin e Kosovës.

Serbia e mohon këtë, duke thënë se ata janë arrestuar në territorin e saj.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se më herët se, mesa duket, prokurori në Serbi i ka hedhur poshtë akuzat për terrorizëm kundër tre policëve të arrestuar, ndërsa i ka mbajtur në fuqi vetëm akuzat për posedim të paligjshëm të armëve.

Kurti i bëri komentet gjatë një adresimi në Forumin e Prespës në Strugë. “Dua ta falënderoj

Departamentin Amerikan të Shtetit që kërkoi lirimin e menjëhershëm dhe pa kushte të tre policëve të Kosovës. Kjo është rruga përpara. Së pari, këta policë duhet të kthehen por, në të njëjtën kohë, bashkësia ndërkombëtare duhet ta dënojë me vendosmëri dhe qartë agresionin e Serbisë në Kosovë”, ka thënë Kurti.

Ai, po ashtu, tha se NATO-ja duhet ta dënojë shkëlqen që sipas tij, i bëri Serbia Marrëveshjes së Kumanovës, e cila i dha fund luftës në Kosovë më 1999.

Qeveria e Kosovës beson se autoritetet serbe, sipas saj, “i rrembyen” tre policët për shkak

të arrestimit të serbit Millun Millenkoviç nga Policia e Kosovës më 13 qershor, nën dyshimet se ka organizuar dhunë kundër pjesëtarëve të misionit të NATO-s, KFOR, në veri të Kosovës.

Kjo zonë, e banuar me shumicë serbe, është tensionuar qysh në fund të majit, kur Policia e Kosovës i ndihmoi kryetarët shqiptarë të komunave atje të futen në objektet e tyre përkundër rezistencës së banorëve lokalë.

Këto objekte shfrytëzohen edhe nga strukturat paralele serbe. Tensionet kulmuan më 29 maj, kur protestuesit serbë u përleshën me ushtarë të KFOR-it.

Dhjetëra të plagosur u raportuan në të dyja anët.

Bashkësia ndërkombëtare kërkon nga Kosova që menjëherë ta shtensionojë situatën, përkatësisht t'i tërheqë njësitë speciale të policisë nga veriu, të organizojë zgjedhje të reja lokale dhe të kthehet në dialog me Serbinë.

Nga Beogradi zyrtar, në anën tjetër, kërkohet ta sigurojë pjesëmarrjen e pakushtëzuar të serbëve në zgjedhjet e mundshme lokale.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme të prillit, nga të cilat dolën kryetarët shqiptarë, u bojkotuan nga komuniteti serb.



Bruksel në një takim të thirrur nga përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell.

Borrelli një ditë më parë ka thënë se do t'i ftojë përfaqësuesit e Kosovës dhe të Serbisë javën e ardhshme në Bruksel, në një takim urgjent për menaxhim të krizave. “Në lidhje me ftesën e zotit Borrell që të takohemi në Bruksel, e kam pak të çuditshme sepse kur e pyetëm për një takim në Bruksel javën e kaluar, ai tha se së pari na duhet shtensionim i situatës. Dhe

menjëherë pas rrembimit të tre policëve nga Njësia Speciale e Serbisë, Borrelli kërkon takim të nivelit të lartë. Kur përshkallëzimi është i madh sa një mal, atëherë marr ftesë për takim në Bruksel, kurse kur e kërkova vetë takim, thanë se më nevojitet ta shtensionoj situatën”, ka thënë Kurti, duke shtuar se: “Ende nuk kam vendosur se a do të shkoj, mirëpo do ta informoj me kohë z. Borrell”.

Komentet Kurti i ka bërë gjatë paraqitjes në një panel në kuadër

të Forumit të Prespës që po zhvillohet në Strugë të Maqedonisë së Veriut më 16 qershor. Ai gjatë kësaj paraqitjeje tha se ajo çfarë i duhet rajonit është që Serbia ta deklarojë pavarësinë nga të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë dhe të heqë dorë nga politikat e saj, që ai i vlerëson hegjemoniste. “Jemi në këtë moment problematik, por me marrëveshjen bazë që u dakorduam, që bazohet në njohjen de facto të njëra-tjetres, besoj se mund t'i normalizojmë

marrëdhëniet dhe ta qetësojmë situatën në terren”, ka thënë ai. Kryeministri përsëriti se është i gatshëm të shpallë zgjedhje të jashtëzakonshme në komunat veriore të Kosovës kur të përgatitet terreni për të bërë një gjë të tillë, përndryshe nuk “mund t'ia dorëzojë republikën demokratike një policie fashiste”. “Unë nuk mund të kompensoj Beogradin zyrtar për humbjet e shkaktuara ndaj Serbisë si shtet për shkak të regjimit të Millosheviçit. Kjo është një çështje krejtësisht tjetër dhe ne

duhet t'i ndajmë kërkesat politike nga krimi i organizuar dhe bandat kriminale”, ka thënë Kurti.

Tensionet në veri të Kosovës janë të larta që prej 26 majit, kur kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri - të banuara me shumicë serbe - kanë hyrë në ndërtesat komunale. Serbët lokalë kanë kundërshtuar diçka të tillë dhe protestojnë vazhdimisht para ndërtesave komunale që prej 29 majit. Komuniteti ndërkombëtar e ka kritikuar Prishtinën zyrtare për nxitje të tensioneve.



## Çitaku: Politika jonë kombëtare nuk duhet të diktohet nga ajo se çka thotë apo mendon Serbia

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Nënkrjetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, duke reaguar për zhvillimet në vend, ka theksuar se Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. “Si të tillë na trajton ShBA-ja, dhe si të tillë na trajtojnë mbi 100 shtete anekënd botës që na kanë njohur. Kjo e arritur epokale është ndërtuar me

mund e sakrificë, dhe nuk do të ishte e mundur pa ndihmën e aleatëve tanë. Por na takon neve, si Kosovë, që të sillemi si shtet. Të matur, të mençur, të përgjegjshëm”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”.

Ajo ka theksuar se politika jonë kombëtare nuk duhet të diktohet nga ajo se çka thotë,

apo mendon Serbia. “Çka humbë, apo çka fiton Serbia. Imagjinojeni sikur kjo mendësi të mbizotëronte te klasa politike në vitin 1999 apo 2008. Ne duhet të jemi të motivuar dhe të përqendruar në atë çka mund të arrijë, dhe çka të rrezikon të humbas Kosova. Kosova meriton më mirë”, ka shkruar Çitaku.



KOMENT I VOGËL PËR NJË PROBLEM TË MADH

# KUSH PO E TRADHTON INTERESIN SHTETËROR DHE INTERESIN KOMBËTAR

Milazim KRASNIQI

Qëndrimi i Tiranës zyrtare ndaj qeverisë Kurti, duke anuluar edhe mbledhjen e përbashkët të dy qeverive, është pasojë e konfrontimit direkt të Kurtit me ShBA-në, BE-në dhe me NATO-n. Tërheqja e qeverisë së Tiranës do të ketë synuar të përçojë mesazhin se ai konfrontim është i dëmshëm dhe se rreziku i konfliktit të qeverisë Kurti me komunitetin serb në veri kërkon deeskalim urgjent, qoftë me çmimin e izolimit të Kurtit. Nga ajo që është parë deri sot, nga ShBA, BE e NATO, Kurti po mbahet përgjegjës për eskalimin, prandaj edhe u është ekspozuar presioneve, gjë që qeveria e Tiranës nuk mund ta ndryshojë.

Realisht, Shqipëria si anëtare e NATO-s nuk mund të dalë kundër qëndrimit të Aleancës, sepse interesat e saj janë që të jetë partner i besueshëm edhe në situata të këtilla të vështira, të ngarkuara me sentimente kombëtare. Pra, Shqipëria edhe në këtë rast ndjek interesat e veta shtetërore, sepse as nuk sheh që në këtë konflikt po mbrohet ndonjë kauzë kombëtare. E kundërta po ndodhë me këtë krizë, po kërcënohet interesi shtetëror i Kosovës e me këtë realisht atakohet edhe interesi



kombëtar shqiptar.

Kosova nga ana e saj, në këtë konflikt ka hyrë pa pikë nevojë: për targat e veturave në komunat veriore. Tash targat janë harruar, ndërsa qeveria Kurti po merret me pasojat zingjirore që janë shkaktuar nga ai vendim i gabueshëm. Në fakt vendim i gabueshëm ishte edhe mbajtja e zgjedhjeve në komunat veriore, para se të sigurohej pjesëmarrja e serbëve në zgjedhje.

Përtej kësaj krize konkrete në veri dhe konfrontimit të qeverisë Kurti me komunitetin euro-atlantik, reagimi hysterik i qarqeve proqeveritare të Kosovës ndaj Shqipërisë, zbulon një gjendje të rënduar emocionale dhe psikologjike. Reagimi aq i ndyrë zbulon se Kosova ende është një vend rekonvalescent, në raport me jugonostalgjinë titiste dhe me shqiptaronostalgjinë enveriste. Urrejta iracionale ndaj

Shqipërisë e njërit grup e ka burimin te propaganda titiste kundër Shqipërisë, ndërsa zhgënjimi me Shqipërinë e ka burimin te irredentizmi me paketim enverist, në anë tjetër. Në të dyja rastet, akuzat dhe vajtimet janë infantile, naive dhe të dëmshme.

Për të gjithë njerëzit do të duhej të ishte e qartë se Kosova si shtet më vete, ka obligimet e veta dhe nuk mund t'i anashkalojë pa pasojat. As Shqipëria e askush

tjetër nuk mund ta ndihmojë Kosovën, nëse udhëheqja e saj merr vendime të dëmshme, ashtu siç është duke vepruar qeveria Kurti. Kosova vetë e ka zgjedhë këtë qeveri, e cila ka orientime të forta antiperëndimore dhe antidemokratike. Është e ditur se LVV që nga themelimi i saj ka qenë parti me orientim antiperëndimor dhe antidemokratik, sepse e ka përdorë brutalisht dhe masivisht dhunën, për arritjen e qëllimeve politike.

Nga ana tjetër, duhet të jetë e qartë se sa më shumë që Kosova dobësohet si shtet, shkak i gabimeve të qeverive të veta, aq më shumë mund të rritet arbitrariteti i faktorëve ndërkombëtar. Në atë pako edhe “protektorati vëllazëror” i Shqipërisë, si tentativë për të minimizuar pasojat. Pse? Sepse Kosova de jure është krizë ndërkombëtare. Në një gjendje të tillë, të gjithë aktorët, duke përfshirë edhe Shqipërinë, përpiqen të shmangin efektet dhe pasojat e krizës. Pasojat nuk shmangen me nostalgji naive nacional-romantike e me ideologji korozive. Ato mund të shmangen me realpolitikë. Cilado palë që del nga realpolitika, de facto e tradhton interesin shtetëror dhe interesin kombëtar. (16 qershor 2023)

## AGK-ja: Dënojmë sulmin brutal ndaj gazetarëve në Leposaviq

Prishtinë, 16 qershor - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka njoftuar se ekipet e gazetarëve nga Prishtina “kanë qenë cak i një sulmi brutal” nga protestuesit në Leposaviq derisa po kryenin punën e tyre. Sipas AGK-së, kameramani i shërbyesit publik, Radio Televizionit të Kosovës, Bardh Bekteshi, është sulmuar fizikisht dhe ka marrë lëndime të rënda në kokë dhe trup. “Përveç sulmit fizik, Bekteshi i është thyer edhe kamera e xhirimit”, thuhet në

njoftimin e AGK-së.

Ky asociacion ka publikuar edhe një video ku shihet sulmi ndaj gazetarëve në Leposaviq. Sipas një deklaratë për AGK-në, gazetarja Venera Xhoxhaj ka treguar se protestuesit i kanë gjuajtur me gurë ekipet e medie, Tëvël, RTV Dukagjini, RTK, Klan Kosova dhe KTV. “Na kanë gjuajtur me gurë, disa kolegë derisa kanë qenë duke u larguar, janë rrëzuar, dhe kameramanin tonë, Bardh Bekteshi, e kanë shtyrë duke e rrëzuar pastaj edhe sulmuar

fizikisht, duke i shkaktuar lëndime në kokë dhe trup”, ka thënë Xhoxhaj për AGK-në. “Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës i bën thirrje urgjente Policisë së Kosovës, dhe prezencës ndërkombëtare në këtë komunë, që t’u ofrojnë siguri gazetarëve dhe kameramanëve të cilët janë duke qëndruar në atë komunë”, thuhet në reagimin e AGK-së e cila e ka dënuar ashpër sulmin.

AGK-ja ka thënë se për të gjitha sulmet ndaj gazetarëve, të cilat kanë ndodhur gjatë



raportimeve të tyre nga veriu i vendit, do të informohen organizatat ndërkombëtare

që merren me sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e medias.



# Reagime të shumta në përkrahje të “Klan Kosovës” dhe kundër vendimit të MINT

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh shqetësimin e thellë lidhur me vendimin e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë së Kosovës për pezullimin e certifikatës së regjistrimit të biznesit të televizionit “Klan Kosova”. “Ky vendim jo vetëm që shkel dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare por dërgon një mesazh shqetësues për komunitetin e biznesit dhe investitorët potencialë. Si përfaqësues të komunitetit të biznesit amerikan në Kosovë, ne besojmë fuqishëm në respektimin e parimeve të praktikave të drejta dhe transparente të biznesit, si dhe në mbrojtjen e të drejtave të bizneseve që operojnë brenda vendit. Pezullimi arbitrar i certifikatës së regjistrimit të biznesit të Klan Kosovës ngrë shqetësime për stabilitetin dhe parashikueshmërinë e mjedisit të biznesit në Kosovë. Veprime të tilla gërryjnë besimin e komunitetit të biznesit, si vendor ashtu edhe ndërkombëtar, dhe dekurajojnë investimet. Vendimi bie ndesh me parimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, i cili synon të krijojë një mjedis të favorshëm për bizneset për të lulëzuar, kontribuar në ekonomi dhe për të krijuar mundësi punësimi”, thuhet në reagimin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Sipas kësaj ode, ky vendim nxjerr në pah nevojën për një gjyqësor të pavarur dhe procedura transparente ligjore. “Vendimi i ministrisë për të pezulluar certifikatën pa arsyetimin e duhur ose pa një proces të rregullt ligjor cenon sundimin e ligjit. Është thelbësore që çështjet ligjore, si pezullimi i certifikatave të regjistrimit të biznesit, të trajtohen përmes proceseve të drejta dhe transparente, duke siguruar që bizneset të kenë mundësinë të mbrojnë interesat e tyre dhe të trajtojnë çdo shqetësim në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Po ashtu pezullimi i certifikatës së regjistrimit të biznesit të Klan Kosovës ka implikime më të gjera për lirinë e medieve dhe mbrojtjen e pavarësisë së gazetarisë. Mediet luajnë një rol kritik në promovimin



e transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë. Çdo veprim që kufizon funksionimin e organizatave mediatiqe i minon këto parime dhe ngrë shqetësime për gjendjen e lirisë së shtypit në Kosovë. Vendimi krijon një precedent shqetësues dhe mund të pengojë mediet e tjera të raportojnë lirisht dhe objektivisht”, theksohet në reagim.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë kërkon nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që ta rishqyrtojë vendimin e saj për pezullimin e certifikatës së regjistrimit të biznesit të televizionit Klan Kosova. “Respektimi i parimeve të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe sigurimi i një mjedisi biznesi transparent dhe të parashikueshëm janë jetike për nxitjen e rritjes ekonomike dhe tërheqjen e investimeve. Për më tepër, ruajtja e lirisë së medies dhe promovimi i pavarësisë gazetareske janë thelbësore për një demokraci të qëndrueshme. Ne i bëjmë thirrje Ministrisë që ta korrigjojë këtë situatë, të rikthejë besimin në komunitetin e biznesit dhe të riafirmojë përkushtimin e saj për respektimin e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të bizneseve në Kosovë”, theksohet në reagimin e Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Edhe Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka shprehur shqetësimin e

thellë ndaj rastit të “Klan Kosova”. “OEK-u është e shqetësuar edhe më tepër me implikimet që sjell ky vendim, sidomos me mundësinë që të mbyllet ‘Klan Kosova’ si medium. ‘Klan Kosova’ është ndër mediet që ka bërë më së shumti për promovimin e bizneseve vendore, prandaj çdo cenim i medies ‘Klan Kosova’ është edhe cenim i promovimit të prodhimeve kosovare. Për më tepër OEK-u është e shqetësuar edhe me implikimet që një vendim i tillë, pa respektuar procedurat administrative, do të ketë në imazhin e Kosovës si vend që tenton të tërheq investime të huaja. Prandaj, OEK apelon për vendimarrje të drejtë, të bazuar në procedurat e ligjet gjegjëse si dhe respektim të të drejtave të bizneseve por edhe për pacenueshmëri të lirisë së shprehjes”, është thënë në reagimin e OEK-ut.

Organizatave të ndryshme të lirisë së medies në botë, Bashkimin Evropian dhe ambasadorët e Quint-it në Kosovë, i janë bashkuar shqetësimit të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe organizatave të tjera mediale në Kosovë për vendimin e qeverisë për ta pezulluar certifikatën e biznesit të “Klan Kosovës”, me thirrjen për Komisionin e Pavarur për Media - KPM, që ta trajtojë rastin me kujdes dhe pa u ndikuar.

## KPM: “Klan Kosova” obligohet që brenda 30-ditësh ta plotësojë dokumentacionin e biznesit

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) i ka dhënë afat prej 30 ditëve televizionit “Klan Kosova”, që ta plotësojë dokumentacionin e nevojshëm të biznesit në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK). KPM-ja tha se dështimi për të vepruar në pajtim me rregulloren e shërbimeve mediale, brenda afatit të përcaktuar, do të rezultojë me masa sanksionuese, sipas ligjit.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Qeverisë së Kosovës më 14 qershor ngriti kallëzim penal ndaj Shoqërisë Tregtare “Klan Kosova SHPK”. Kallëzimi penal u ngrit me “pretendimin se në certifikatën e biznesit, te ndërrimi i pronarëve, figuron Pejë - Serbia dhe Gjakovë - Serbia”. ARBK-ja në bazë të akteve ligjore ka marrë vendim që ta pezullojë certifikatën e biznesit të televizionit “Klan

Kosova” deri në një vendim tjetër. KPM-ja në mbledhjen e mbajtur të premten ka sqaruar se rregullorja e KPM-së për dhënën e licencës për shërbime mediale kërkon që kompania private të jetë ligjërshet e regjistruar në Kosovë.

KPM-ja tha se është njoftuar nga ARBK-ja më 14 qershor 2023, se ka pezulluar certifikatën e biznesit për “Klan Kosova”. “Duke pasur parasysh se ofruesi i shërbimit medial, Klan Kosova, është licencuar nga KPM-ja mbi bazën e kësaj certifikate të biznesit, e cila vë në dilemë ligjshmërinë e këtij biznesi, rekomandon që në afat prej 30 ditëve nga pranimi i këtij vendimi të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për mbajtjen e licencës së transmetimit konform rregullores për ofruesit e shërbimeve medieve”, tha Jeton Mehmeti, kryetar i Komisionit të Pavarur për Media.

## Marrëdhënie seksuale në zyrë, jep dorëheqje kryebashkiaku i Kukësit

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Një tjetër kryebashkiak socialist, përfshihet në një skandal me sfond seksual. Pas rastit të ish drejtuesit të Bashkisë së Dibrës, i cili 7 vjet më parë, u filmua duke kërkuar favore seksuale në këmbim të një vendi pune, të premtën në rrejet sociale qarkulloi videoja e kryetarit të Bashkisë së Kukësit Safet Gjici, i rizgjedhur

në këtë post më 14 maj, si përfaqësues i Partisë socialiste, teksa kryente marrëdhënie seksuale në zyrën e tij. Sipas të dhënave në video, filmimi rezultoi të jetë realizuar 10 ditë më parë, rreth orës 16.00.

Reagimi i parë erdhi nga Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të organizuar dhe korrupsionit, kompetencë e së cilës janë dhe veprat penale të

funksionarëve të lartë të shtetit. Kjo prokurori bëri të ditur se kishte nisur një procedim penal, me iniciativë të saj. Kryebashkiaku i Kukësit, njoftoi më pas, përmes një postimi në “Facebook”, dorëheqjen si “një detyrim minimal” ndërsa kërkoi ndjesë publike ndaj “kujtdo që ka parë atë material të shëmtuar video”.





# Gërxhaliu: Dialogu me partneritetin ndërkombëtar, i pazëvendësueshëm për të ardhmen e Kosovës

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 16 QERSHOR** - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka folur për situatën e fundit në vend, sidomos për situatën në veri dhe ndikimin që kjo do të ketë edhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Gërxhaliu në një bisedë për "Epokën e re" ka thënë se Kosova në këtë situatë duhet të jetë në vijë me faktorin ndërkombëtar, aleatët e saj strategjikë, sidomos me ShBA-në. "Kohën e fundit është një debat dhe situatë mjaft e shqetësuar në Kosovë, në veçanti sa iu përket raporteve dhe dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, e sidomos ndodhitë në veri. Në këtë drejtim definitivisht duhet të qetësohen gjakatrat dhe të ketë racionalitet në veprime dhe deklarata. Rasti i policëve të kidnapuar është shqetësues dhe dua të besoj e të pajtohem të gjithë se rruga e vetme për të dalë nga kjo situatë është partneriteti dhe dialogu me faktorin ndërkombëtar. Nuk i bëhet nder Kosovës me një

patriotizëm të ekzaltuar të individëve të caktuar që në emër të patriotizmit janë në gjendje ta kallin Kosovën dhe ardhmërinë e saj", ka thënë ai.

Njohësi i ekonomisë, Gërxhaliu, ka theksuar se sot jemi dëshmitarë që në Kosovë ka shumë pak investitorë të huaj apo fare pak. "Situata aktuale vërtet është shqetësuese dhe duhet të kuptohet që stabiliteti politik është kusht i zhvillimit ekonomik. Në këtë drejtim me këto pamje nga veriu dhe tërë Kosovë do të jetë shumë e vështirë të jemi atraktivë për investitorë të huaj, kur krejt kësaj i shtohet edhe fakti që në kufi janë ndaluar mallra të importit nga Serbia dhe po e shihni se situata është më alarmuese dhe shqetësuese. Në këtë drejtim besoj se duhet gjakftohtësi dhe dialog. Duhet të kuptohet se nuk ka dalje nga kjo situatë pa një mbështetje dhe partneritet të mirëfilltë me ShBA-në dhe me vendet evropiane, në veçanti me KFOR-in dhe EULEX-in. Çdo tentativë tjetër do të jetë dërgesë në humnerë e



Kosovës dhe kjo situatë do t'i gëzojë më së shumti armiqtë e Kosovës sesa vetë kosovarët dhe ardhmërinë e tyre", është shprehur Gërxhaliu. Ai ka shtuar se në kufi janë duke pritur kamionë të ndryshëm me mallra, mirëpo thotë se revolta politike është e arsyeshme falë ndodhive në veri por, sipas Gërxhaliut, duhet të mendohet mirë se çfarë ka në ata kamionë. "Tregtia dhe bashkëpunimi ekonomik duhet t'i eliminojnë muret dhe të krijojnë ardhmëri. Në këtë

drejtim kam drojë se po forcohet informaliteti, kam drojë se mallrat po gjejnë mundësi alternative dhe, në anën tjetër, po rritet informaliteti dhe tërë këtë eksperiment po e paguan qytetari i Kosovës", ka theksuar Gërxhaliu. Ai thotë se është koha kur duhet të ketë qetësim të emocioneve dhe të kemi kujdes si të veprojmë. "Në këtë situatë kur ne mbyllim kufijtë, shtetet e ndryshme forcojnë partneritetin me aleatët strategjikë. Vetë fakti

që po themelohet Këshilli Kombëtar Ekonomik mes Serbisë dhe ShBA-së, dëshmon më së miri agresivitetin diplomatik të Serbisë jo vetëm atë ekonomik, por edhe në fusha të tjera. Nuk i bëhet nder Kosovës në qoftë se të gjithë mbështetësit e lirisë dhe pavarësisë që i ka pasur Kosova, sot të jenë aleatë dhe mbështetës të prosperitetit ekonomik të zhvillimit të Serbisë", ka deklaruar ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu.

## Avokati i Popullit dhe përfaqësues të UN Women Kosovo vizitojnë KEDS-in

**PRISHTINË, 16 QERSHOR** - Avokati i Popullit, Naim Qelaj, me stafin mbështetës dhe përfaqësueset e UN Women Kosovo, kanë vizituar KEDS-in. Vizita kishte për qëllim njohjen me të arriturat e KEDS-it, me fokus perspektivën e barazisë gjinore, si dhe për të bashkëbiseduar rreth kushteve të punës për punonjësit e kompanisë. Kryeshefi ekzekutiv i KEDS-it, Alpin Dogan, dhe përfaqësues të tjerë të kompanisë, prezantuan projektet e realizuara në fushën e barazisë gjinore dhe politikat e kompanisë për kushtet e punës në përgjithësi, duke qenë të hapur për sugjerimet që mund të bëhen në këtë drejtim, me ç'rast Dogan tha se është ihtar i barazisë gjinore në vendin e punës. "Madje uroj që KEDS-i në të ardhmen ta ketë kryeshefe një grua. Ju falënderoj që na nderuat me vizitën tuaj dhe ju lutem ndihuni të hapur për çdo sugjerim që mund të ndihmojë në avancimin e mëtejshëm në

këtë fushë", është shprehur Dogan.

Ndërkaq Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka shtuar se KEDS-i është një prej kompanive më të mëdha në vend dhe është kënaqësi për ta vizituar. "Më la shumë përshtypje ajo që keni bërë si KEDS në fushën e barazisë gjinore. Nga këto projekte shihet që ju keni ndërtuar një politikë të qartë për këtë çështje", ka theksuar Qelaj.

Në prezantimin e KEDS-it u përmend përkushtimi i kompanisë për t'i përmbushur maksimalisht të drejtat e punëtorëve si nga aspekti i mirëqenies dhe sigurisë në punë, po ashtu edhe nga ana e politikave të punës për trajtim meritore dhe jodiskriminues ndaj punonjësve.

Ndërkaq, përfaqësuesja e UN Women Kosovo, Flora Kryeziu-Pajaziti, ka pohuar se KEDS-i ka trasuar rrugën për shumë kompani që t'i nënshkruajnë parimet e UN Women për



Barazi Gjinore në vendin e punës. "Sot kemi 10 kompani në Kosovë që janë pjesë e këtyre parimeve, dhe shpresojmë që ky numër do të vazhdojë të rritet", ka thënë Kryeziu-

Pajaziti. Të pranishmit vizituan edhe punonjësit e departamenteve të ndryshme në KEDS, si: Departamentin e Marrëdhënieve me Publikun,

Departamentin e Sistemit të Operimit, Prokurimit, Qendrën e Thirrjeve, Tregtimin e Energjisë dhe Shërbimin me Konsumatorë, Zonën e Energjisë etj.

## Kamionët me mallra serbe as të premtën nuk janë lejuar të hyjnë në Kosovë

**Prishtinë, 16 qershor** - Asnjë kamion me mallra me origjinë nga Serbia nuk ka hyrë në territorin e Kosovës qëkur Qeveria e

Kosovës ka marrë vendim për ndalimin e hyrjes së kamionëve me prodhime dhe targa serbe në Kosovë dy ditë më parë. "Nuk kemi

pasur asnjë hyrje, është duke u zbatuar masa e sigurisë për ndalimin e hyrjes", tha zëdhënësi i Doganave të Kosovës,

Adriatik Stavileci. Qeveria e Kosovës më 14 qershor ka marrë vendim për t'i shtrënguar kontrollat kufitare me Serbinë.





# Asnjë lidhje me Transilvaninë dhe princin rumun, e vërteta si lindi Drakula



Nga Ronan O'CONNELL

Një erë e fortë fryn pasdite në rrugën e shkretë të Tregut të Vjetër, pranë dyqaneve të mbyllura dhe restoranteve të zhytura në errësirë. Qyteti studentor irlandez Sligo duket sikur ka ngrirë. Ai kaloi 2 muaj në një bllokim të rreptë mbarëkombëtar të zbatuar nga qeveria irlandeze për të luftuar përhapjen e koronavirusit të ri, i cili në Irlandë vrau më shumë njerëz për frymë sesa në SHBA Herën e fundit që Sligo ishte kaq i boshatisur ishte 188 vjet më parë. Dhe në atë kohë fajtoje ishte kolera. Epidemia e saj solli jo vetëm vdekje, varfëri, uri, kaos dhe dezertime, por edhe një vampir legjendar. Megjithatë, vetëm në fund të vitit 2018, studiuesit irlandezë arritën të bëjnë zbulimin befasues: në të vërtetë Drakula lindi në Sligo. Në vitin 1832, në Old Market Street, një vajzë 14-vjeçare irlandeze ishte strukur në shtëpinë e saj gjatë shpërthimit të kolerës, e cila vrau më shumë se 10 për qind të popullsisë së qytetit. Skenat e kobshme rreth saj – varre masive, kufoma në rrugë, viktimat të varrosura për së gjalli – ajo ia tregoi më vonë djalit të saj. Emri i vogëlushit ishte Bram Stoker, dhe ato histori të zymta

ishin një burim frymëzimi për të shkruar “Drakulën”, një nga romanet më me ndikim në historinë e njerëzimit. I botuar për herë të parë në vitin 1897, kjo përrallë me protagonist një vampir ka prodhuar dhjetëra filma, shfaqje, shfaqje televizive dhe libra.

Në romanin e Stoker, një avokat anglez shkon në vargmalet e Transilvanisë në Rumani, ku viziton një vend të izoluar të quajtur Kalaja e Drakulës. Atje ai sulmohet dhe burgoset nga vampiri që pi gjak, Konti Drakula. Pjesa tjetër është shumë e njohur. Midis shumë teorive të kahershme rreth frymëzimit të Stoker mbi Drakulën, më populloreja është ajo sipas së cilës autori u motivua nga Vlad Hungulësi, një udhëheqës sadist rumun i famshëm për torturimin e armiqve të tij osmanë. Ky princ i shekullit XV-të quhej gjithashtu Drakulea.

Megjithatë, këtu duket se përfundojnë lidhjet midis Drakulës dhe Drakuleas. Pavarësisht nga mjedisi transilvanian – dhe fakti që Kështjella Bran e atij rajoni quhet sot edhe Kështjella e Drakulës – dëshmitë historike tregojnë se Vladi kishte pak lidhje me atë zonë dhe për më tepër nuk ka jetuar kurrë në atë kështjellë. Pra përtej titullit të librit, ku i lindi Stoker ideja për Drakulën, një

vampir që kishte vdekur por ishte ngjallur dhe që i infekton ata që kafshon, duke i shndërruar në vampirë? Përgjigja qëndron në Sligo, një qytet piktoresk që sot banohet nga 20.000 njerëz dhe që ndodhet në bregun perëndimor të Irlandës, i rrethuar nga pyje të dendura, male të gjelbër, plazhe ku fryn gjithmonë erë dhe lumenj të pasur me salmon.

Kështu pretendon historia irlandez Merion Mekgeri, anëtare e Shoqërisë Sligo Stoker, e cila ka bërë kërkime të përpikta mbi lidhjet midis Drakulës dhe epidemisë së kolerës në këtë qytet të vogël. Mekgeri thotë se Stoker u frymëzua nga një rrëfim i frikshëm i asaj epidemie të shkruar nga nëna e tij, Sharlot Tornlej, e cila u izolua në shtëpinë e saj përpara se të ikte nga Sligo me familjen e saj.

Eseja e Tornlej mbeti e pabotuar dhe e ruajtur në një arkiv në Dublin, derisa Shoqëria Sligo Stoker e studioi tekstin dhe vitin e kaluar e shpërnda gjerësisht. “Kur u rrit Bram i kërkoi nënës së tij t’i shkruante kujtimet e saj mbi epideminë dhe ai e plotësoi rrëfimin duke përdorur hulumtimin e tij historik mbi epideminë e Sligos. Duke hulumtuar unë gjeta disa paralele me Drakulën.

Për shembull, Sharlot thotë se kolera hyn në qytetet portuale pasi ka udhëtuar me anije, dhe se

ajo mund të udhëtojë në tokë si një mjegull. Pra njëllon si Drakula, që i infekton njerëzit”- thotë historiania.

Megjithatë, lidhja më e fortë që gjeti ajo, ishte midis gjendjes së ndërmjetme të Drakulës – të qenit njëkohësisht i vdekur dhe i vetëdijshëm – dhe përshkrimit të Tornlej mbi viktimat e kolerës që u varrosën të gjallë. Stoker u magjeps shumë nga ky detaj. Aq sa titulli i parë i romanit që “The Undead”, përpara se botuesi i tij ta ndryshonte më vonë atë në “Drakula”.

Historitë e kolerës që i rrëfeu Tornlej Stokerit ishin realiste, thotë Fiona Galager, historiane irlandeze që e është marrë me studimin e asaj epidemie. Përhapja vrau deri në 1000 banorë të Sligos dhe shkaktoi kaos. Për t’i ndaluar banorët të arratiseshin nga qyteti i prekur nga sëmundjet (dhe më pas përhapja e saj në vende të tjera), rreth Sligos u hapën llogore dhe u ngrit një bllokadë rrugësh.

Kolera e sulmoi Sligon aq fort dhe shpejt sa që kufomat shtriheshin në rrugë, dhe 20 marangozët e qytetit nuk mundeshin të përballonin dot kërkesën për arkivole. “Shumë trupa mbetën pa arkivole”- thotë Galager. Ndaj rreth 500 viktimat u mbështollën me çarçafë dhe u varrosën në një varr masiv.

Shumica e mjekëve dhe

infermierëve në Sligo vdiqën nga sëmundja. Shumica e klerikëve u larguan dhe banorët e bllokuan në qytet u rebeluan. Banorëve të Sligos siç ishte edhe nëna e Stoker, po u dukej se bota po merrte fund. Sligo, shkroi Tornlej në dëshminë e kërkuar nga djali i saj ishte bërë “si një qytet i të vdekurve”.


Sharlot thotë se ndërsa epidemia përshkallëzohej, personeli infermieror i tmerruar do t’i merrte pacientët, që më parë ishin trullorur me laudan ose opium, dhe do t’i vendoste të gjallë në varrezat masive thotë Mekgeri. Përshkrime të tilla, pohon shkrimtari, e ndezën imagjinatën e tij.

Edhe pse ishte një figurë shumë e rezervuar, autori e pranoi në një intervistë të rrallë mbi romanin “Drakula”, se historia ishte “frymëzuar nga ideja e dikujt që u varros para se të vdiste plotësisht”. Vitin e kaluar, Sligo e ka përqafuar këtë lidhje të sapo zbuluar me Drakulën dhe shpreson ta përdorë atë për të tërhequr turistët.

Një nga pasardhësit e Stoker, shkrimtari kanadez Dakre Stoker, e vizitoi qytetin vitin e kaluar për të marrë pjesë në një ngjarje që festonte lidhjet e Sligos me Drakulën. Pra Drakula nuk ka asnjë lidhje me Transilvaninë. Ai lindi në Sligo, dhe ishte produkt letrar i një epidemie.



**EUROGLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enverti  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Kosova mëson rivalët për kualifikimet evropiane U17 dhe U19 për vajza

**NION, 16 QERSHOR** - Në selinë e UEFA-së në Nion të premtën është bërë tërheqja e shortit për fazën e parë kualifikuese për Evropianin "Suedia 2024" për U17 dhe për Evropianin "Lituania 2024" për U19. Edhe këtë herë ekipet u ndanë sikurse

në formatin e Ligës së Kombeve, në Ligën A dhe Ligën B. Kosova në të dyja grupmoshat është përfshirë në Ligën B, ku do të synojë të promovohet në Ligën A. Në shortin për U17, Kosova u përfshi në Grupin B1, ku bëjnë

pjesë edhe Maqedonia e Veriut, Gjeorgjia dhe Armenia. FFK-ja do të jetë organizatore e miniturneut të këtij grupi, ndeshjet e të cilit do të zhvillohen më 3, 6 dhe 9 tetor. Kjo do të jetë hera e dytë që FFK-së i është besuar

organizimi i një turneu të tillë nga UEFA. Ndërkaq, Kombëtarja U19 është përfshirë në Grupin B3 ku janë edhe Sllovenia, Azerbajxhani dhe Moldavia. Ndeshjet e këtij grupi do të zhvillohen në Slloveni, më 8, 11 e 14 nëntor.



## Kosova barazon me Rumaninë, ëndrra për kualifikim edhe me larg

"Dardanët" kanë barazuar në Prishtinë me Rumaninë dhe në këtë mënyrë janë edhe me larg ëndrrës për kualifikim në Evropian. Përzgjedhësi Alain Giresse ka thënë se fusha e renduar pas reshjeve të shiut ndikoi në mos fitoren e Kosovës, derisa nuk heq dorë për kualifikim. "Përderisa na lejon matematika, ka gjithmonë një shans dhe ne nuk dorëzohemi", ka thënë pas ndeshjes Giresse

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 16 QERSHOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka regjistruar barazimin e tretë radhazi në kualifikimet për Kampionatin Evropian "Euro 2024", pasi luajti baras ndaj Rumanisë me rezultat 0-0. Në ndeshjen e zhvilluar në

stadiumin "Fadil Vokrri", Kosova ishte dominuese ndaj Rumanisë, derisa arriti edhe të shënonte gol, por pas rishikimit të VAR-it goli i Edon Zhegrovës nuk u pranua. "Dardanët" ishin dominues në pjesën e parë të ndeshjes, derisa i patën edhe tri raste të mira shënimi të cilat nuk arritën t'i konkretizojnë në gol, Muriqi, Cenja dhe Muslija. Edhe në



pjesën e dytë, Kosova ishte skuadër më e mirë dhe dominimi ishte thuasje gjatë gjithë kohës. Vojvoda lëshoi një rast të mirë shënimi më pas

edhe Zhegrova, derisa në minutën e 69-të, anëtori i Lille, Edon Zhegrova realizoi për 1-0, por gjyqtari e anuloi pas rishikimit të VAR-it. Muriqi pati

edhe një rast të mirë në fund të ndeshjes, por topi përfundoi mbi portën e mysafirëve dhe ndeshja përfundoi 0-0. Pas ndeshjes, trajneri i Kosovës, Alain Giresse ka thënë se gjendja e fushës ka ndikuar që "dardanët" nuk arritën të fitojnë ndeshjen. "Terreni dhe fundit mund të bënim më mirë. Por, terreni mbetet faktor kryesor në shkakun pse nuk gjetëm golin. Në fundin e lojës, Muriqi shpërdoroi rast të mirë. Përderisa na lejon matematika, ka gjithmonë një shans dhe ne nuk dorëzohemi", ka thënë pas ndeshjes Giresse. Ky ishte barazimi i tretë i Kosovës në kualifikueset për "Euro 2024", derisa të hënën përballlet me Bjellorusinë në Budapest.

## Nora Gjakova, e argjendte në Kazakistan


**PEJË, 16 QERSHOR** - Xhudistja Nora Gjakova e ka fituar medaljen e argjendte në Grand Slam-in e Xhudos që po mbahet në Astana të Kazakistanit. Kampionia olimpike e Kosovës u ndal në finale nga francezja Sarah Leonie Cysique. Deri në finale Nora arriti duke shënuar katër fitore, njëherë pa luftë, kategoria -57 kg. Gjakova fitoi edhe 700 pikë olimpike për

"Paris 2024". "Medalje e argjendte për Norën në Ditën e Çlirimit të qytetit të saj të lindjes - Pejës! Nora Gjakova shënoi tri fitore për t'u ndeshur në finale me francezën Qysique e ku mirë e filloi luftën dhe u prit luftë e fortë, por një gabim i kushtoi, por kjo s'e humb shkëlqimin e medaljes së argjendte të Norës dhe 700 pikë Olimpike! Mposhti me Ippon

garueset nga Latvia, Polonia dhe në gjysmëfinale garuesen nga Holanda. Nora tashmë vulosi normën drejt Lojërave Olimpikë dhe lufta është të mbetet në top 8 që të jetë ndër bartëset e grupeve", ka shkruar Kuka në "Facebook". Sot (e shtunë) garojnë Akil Gjakova (-73 kg), Laura Fazliu (-63 kg) dhe Lorian Kuka (-70 kg).



## Nuzës i besohet drejtësia në ndeshjen kualifikuese 'Euro 2024'



Prishtinë, 16 qershor - Gjyqtari Genc Nuza ka marrë një superlajm nga UEFA, pasi ia ka besuar ndarjen e drejtësisë në kualifikimet për Kampionatin Evropian. Kjo është hera e parë që një gjyqtar i futbollit të Kosovës ndan drejtësinë në këtë nivel. Nuza do ta ndaj drejtësinë në sfidën Finlanda - San

Marino, kurse do të ndihmohet nga Fatlum Berisha dhe Bujar Selimaj. "Kam kënaqësinë të ndaj me ju edhe një tjetër arritje si gjyqtar ndërkombëtar i futbollit. Kosova do të përfaqësohet edhe me gjyqtar në ndeshjet kualifikuese për 'Euro 2024'. Jam shumë i lumtur për një tjetër sukses dhe se ky

emërim për ndeshjen Finlanda - San Marino dëshmon edhe njëherë vlerësimin e punës sime profesionale nga ana UEFA-s. Krenar dhe i nderuar të jem gjithmonë gjyqtari i parë i Kosovës i cili bën debutime në kompeticione të rëndësishme ndërkombëtare ndër vite. Paraqitjet në stadione siç është

'Helsinki Olympic Stadium' me shumë histori, dikur ishin ëndërr, tani janë realitet dhe se me punë do të synoj suksese edhe më të mëdha në të ardhmen. Së bashku me ekipin tim dhe kolegët nga Kroacia të cilët do të asistojnë nga sistemi VAR. Uroj të kemi fat dhe sukses!", ka shkruar Nuza.

## Muja: Nuk refuzohet oferta e klubit më të madh në Kosovë

Prishtinë, 16 qershor - Ardian Muja është futbollisti më i ri i skuadrës së Prishtinës. Skuadra kryeqytetase e ka paraqitur futbollistin 25-vjeçar i cili në

gjashtë edicionet e fundit ishte kapiten i Trepçës '89. Muja ka nënshkruar për dy vjet me ekipin e Prishtinës, ndërsa në edicionin e fundit ka shënuar 6

gola dhe 2 asistime. "Nuk e pata të vështirë fare të pranoja ofertën 'bardhekaltër'. Realisht Prishtina është klubi më i madh në Kosovë. Normalisht e ndiej

veten të gatshëm të marr mbi supë skuadrën dhe të jap më të mirën edhe, pse jo, ta rikthejmë edhe titullin e kampionit në kryeqendër", ka thënë Muja.





## Irvingu e fton LeBronin të shkojë te Dallasi

Dalls, 16 qershor - I transferuar në shkurt te skuadra e Dallas Mavericksit, basketbollisti Kyrie Irving po përpiqet të sjellë në Teksas edhe katër herë kampionin e NBA-së, mikun e tij LeBron Jamesi. Lajmin e konfirmojnë mediet amerikane, që shtojnë se Irvingu ka biseduar me "king

James" për ta bindur të ndryshojë fanellë pas deklaratës së tij se mund të tërhiqet nga sporti. Përveç kërkesës për ta sjellë te Dallasi, Irvingu është përpjekur të kuptojë edhe planet që ka LeBron për të ardhmen. Një lëvizje disi e papritur kjo e Irvingut, që nga 1 korriku do të


jetë lojtar i lirë (free agent) dhe mund të ndryshojë skuadër. Disa herë është përfolur që LeBron Jamesi e ka kërkuar Kyrie Irvingu te lakersat, ndaj kjo ide nuk është ende e pamundur për t'u realizuar. Pritet që lakersat të ofrojnë te Dallasi Rui Hachimura, Jarred Vanderbilt e ndonjë tjetër për

ta realizuar këtë transferim dhe kënaqur kapitenin. LeBron James ka një kontratë deri në vitin 2025 me lakersat, por pas një viti mund të bëhet lojtar i lirë. Me fanellën e lakersve ai fitoi një titull (2020), ndërkohë që këtë sezon shkuan deri në finalen e "play-off"-it në Konferencën e Perëndimit.



## Sylvinho: Shqiptarët janë fanatikë të futbollit, nuk kam nevojë për përkthyes

TIRANË, 16 QERSHOR - Shqipëria zë vendin e 68 në renditjen e FIFA-s, por vë bast për Sylvinhon dhe stafin e tij teknik "multikulturore", siç thotë ai vetë në një intervistë për "Ge.globe", për të fituar një vend në "Euro 2024", e cila do të ishte pjesëmarrja e dytë pas 2016-s. Pranë tij ndodhet Doriva, i cili ishte asistent edhe te Corinthians dhe argentinasi Pablo Zabaleta, i cili po fillon karrierën si asistent. "Jemi të rinj dhe po kërkojmë hapësirat tona. Për 10, 12, 13 vjet kam marrë pjesë në komisione teknike dhe nuk e kam parë veten që të drejtoja një kombëtare, megjithëse mora shumë përvojë në kombëtaren braziliane... dhe kjo më ndihmoi në zgjedhjen time. Brazili më ndihmoi të kuptoja se çfarë ishte kjo punë. Nuk jam ulur këtu ku jam dhe të them 'Po tani çfarë'. Në fund të fundit, ne nuk mund të projektojmë gjithçka dhe e pashë si një mundësi shumë të mirë. Më pas, duke bashkuar atë që po ndodh, atë që tashmë po ndryshon pak në këtë rrugë... Në ekipet kombëtare punojnë edhe disa trajnerë më të rinj. Unë po shoh një trend të trajnerëve të rinj që marrin federatat, ekipet kombëtare dhe zhvillojnë



punën e tyre. E kam mirëpritur gjithmonë zgjedhjen tonë këtu në Shqipëri", ka thënë Sylvinho. Mes kaq shumë përgjegjësish, Sylvinho la gruan dhe djalin e tij në Porto të Portugalisë, ku jetoi pasi u largua nga Corinthians dhe shkoi të jetonte në një hotel në Tiranë, i pozicionuar afër FSHF-së dhe "Air Albania"-s, një stadium i inauguruar në vitin 2019 dhe pret ndeshjet e Kombëtares. "Kur thashë që ia kaloj, nuk ishte në shqip, ishte në italisht (qesh). Gjuha nuk funksionon, është vërtet e vështirë, por rezikoj me disa fjalë, mirëmëngjesi, mirëdita, natën e mirë... Janë fjalë të izoluar, është shumë e vështirë. Kështu që ia dal me gjuhët e tjera", u shpreh ai. Sidoqoftë, gjuha më e përdorur

është ajo e topit. Së fundmi u bë virale një video e Sylvinhos duke luajtur me futbollistët e tij dhe ndërhyrja ndaj Abrashit, duke treguar intensitetin, por edhe pjekurinë e një trajneri që ndihet i sigurt me hapat e tij, pa i kaluar kufijtë. "Meqenëse e njoh veten si trajner, kam marrë shumë komplimente nga trajnerë të mirë e të sigurt. Gjithmonë jam kujdesur të di nëse mund të futem apo jo në një rreth stërvitor dhe pasi kam biseduar me këta top trajnerë më kanë thënë: 'Ke të gjithë kapacitetin, gjendjen, arsimin, nuk do ta teprosh. Dhe ky jam unë, nuk do të kufizoj kurrë potencialin dhe pikat e forta që më duhet të kem me futbollistët", ka shtuar Sylvinho.

## Trajneri i Spanjës: Ishim më lart se Italia, tani dua trofeun

MADRID, 16 QERSHOR - Trajneri i Spanjës, Luis de la Fuente, ka deklaruar se është krenar për lojtarët e tij dhe paraqitjen e bërë në suksesin kundër Italisë. Ai ka shtuar se "La Roja" e ka merituar plotësisht fitoren, ndonëse jo pa vështirësi. "Këto janë ndeshje me vuajtje. Gjithçka kushton shumë kundër një kundërshtari si Italia, por më të rëndësishme janë përfitimet që kemi marrë. Jam krenar për lojtarët e mi. Ne nuk kemi dyshuar kurrë në veten tonë. Ky është një proces, kërkon kohë dhe me të gjërat do të përmirësohen. Jemi të bindur se diçka e tillë do të ndodhte herët a vonë. Djemtë kanë bërë gjithçka që u kemi kërkuar. Loja ishte një shfaqje mjaft e bukur, veçanërisht në pjesën e dytë, ku e kemi



dominuar takimin", ka thënë Luis de la Fuente. Trajneri i Iberikëve ka komentuar dhe Hoselun dhe golin vendimtar të shënuar prej sulmuesit që flitet se mund t'i bashkohet Realit të Madridit në verë. "Hoselu është një lojtar i madh. Ndryshimet tek ai

kanë qenë fantastike, por e gjithë skuadra është paraqitur mjaft mirë. Te të gjithë kam vënë re një dëshirë për të fituar dhe për ta arritur finalen. Mendoj se jemi me meritë atje dhe të dielën ndaj Kroacisë do të kërkojmë të fitojmë", ka deklaruar Luis de la Fuente.

## Mançini: Spanja e meritoi fitoren

Në përfundim të ndeshjes Spanjë - Itali, ku Iberikët fituan në frymën e fundit me rezultatin 2-1, Roberto Mançini thuri elozhe për kundërshtarin, i cili do të përballlet të dielën ndaj Kroacisë në finalen e Ligës së

Kombeve. "Në fund ata e merituan të fitonin, edhe nëse e gjetën golin në fund. Nuk ishte ndeshja që donim të luanim. Ne bëmë pak në pjesën e dytë. Djemtë bënë gjithçka që mundën. Ndoshta na penalizoi fakti që luajtëm

një lojë taktikisht ndryshe nga zakonisht. Duhej të luanim më mirë, kjo është e sigurt. Ne e kishim vendosur ndeshjen në një mënyrë të caktuar, por ndoshta ky nuk është futbollin ynë. Shkoi mirë pjesa e parë, në pjesën e dytë ne ramë

shumë poshtë dhe nuk ishim ne. Ndoshta duhej të bëja diçka, të ndryshoja diçka. Spanja është një ekip i fortë, edhe kur ata ndryshojnë lojtarë. Ne krijuam një futboll disa vjet më parë dhe, ndoshta, duhet të vazhdojmë

me këtë. Ne e vendosëm kështu duke menduar se mund të bëjmë diçka më mirë. Mendoj sa ka pasur një gjykim të gabuar nga ana ime për formë", është shprehur trajneri i kombëtares italiane, Mançini.

### SHKURT

#### FC Malisheva ndahet me Bylbyl Sokolin

Klubi i Futbollit Malisheva ka njoftuar të enjten mbrëma se me marrëveshje të dyanshme ka shkëputur kontratën me trajnerin Bylbyl Sokoli. Sokoli udhëhoqi Malishevën drejt sigurimit të ekzistencës edhe për edicionin e ardhshëm të Superligës së Kosovës në futboll. Por, Sokoli nuk ka vazhduar bashkëpunimin me Malishevën edhe për sezonin e ri 2023/2024. "FC Malisheva dhe trajneri Bylbyl Sokoli, me dakordim të dyanshëm kanë vendosur që të mos rinovojnë kontratën për sezonin e ardhshëm. Klubi e falënderon profesorin Sokoli për punën profesionale dhe angazhimin e tij me ç' rast edhe realizuam synimin për të cilin ishim dakorduar me rastin e marrëveshjes në janar kur profa mori drejtimin e skuadrës", shkruan në njoftimin e klubit. Sokoli në të kaluarën ka drejtuar shumë skuadra të ndryshme në Kosovë, ndërsa ka punuar edhe në Maqedoni të Veriut.

#### Garcia: Synoj t'i mbaj në majë ngjyrat e kampionëve të Italisë

Rudi Garcia do të jetë trajneri i Napolit për sezonin e ri. Strategu francez rikthehet të drejtojë një ekip në Serinë A pas shtatë vjetësh kur drejtonte Romën. Pas zyrtarizimit në stolin e kampionëve të Italisë, Rudi Garcia ka shkruar në "Twitter" për ndjesitë e tij të para. "Çfarë kënaqësie të vazhdosh në projektin që Napoli ka nisur. Çfarë kënaqësie të rikthehem në Itali. Jam i motivuar dhe ambicioz si kurrë më parë për të vazhduar të mbaj në majë ngjyrat e kampionëve të Italisë", u shpreh tekniku 59-vjeçar. Rudi Garcia mbylli bashkëpunimin e tij me Al-Nassrin në Arabinë Saudite pak muaj më parë dhe ishte një trajner i lirë.

#### Mbappe: Presidenti Macron nuk ka asnjë ndikim në karrierën time

Sulmuesi i PSG-së, Kylian Mbappe, ka thënë se presidenti i Francës, Emmanuel Macron, nuk ka asnjë ndikim në zgjedhjet e karrierës së tij. Në vitin 2021 Mbappe u përfol për një largim nga PSG-ja për t'iu bashkuar Real Madridit dhe në atëkohë presidenti Macron i kishte kërkuar të qëndronte dhe të vazhdonte të luante në Ligën 1. "Në karrierën time, sot për sot, në vitin 2023, asnjë ndikim. Ai dëshiron që unë të qëndroj në Paris. Objektivi im është të qëndroj. Ne jemi në të njëjtën gjatësi vale", ka thënë Mbappe. "Unë i jam përgjigjur tashmë kësaj pyetje, kam thënë se objektivi im është të qëndroj në PSG, ky është opsioni im i vetëm për momentin. Jam gati të kthehem kur të rifillojë faza përgatitore", ka deklaruar Mbappe.

#### Gundogan refuzon dy klube, pëlqen kalimin te Barcelona

Kapiteni i Manchester Cityt, Ilkay Gundogan, thuhet se ka refuzuar dy oferta fitimprurëse këtë verë. Mesfushori i "Citizens", i cili e ndihmoi skuadrën e tij për ta fituar tripletën historike këtë sezon, po i jep fund kontratës me klubin nga "Etihad". Megjithatë, nuk mungojnë klubet e interesuara për 32-vjeçar, i cili ka qenë një nga mesfushorët më të mirë në botë vitet e fundit. Gjermani me origjinë turke ka qenë objektivi i Barcelonës, me ofertën e tyre që e tërheq shumë, pasi tashmë ka refuzuar dy oferta të mëdha. Sipas gazetës "Bild" në Gjermani, Gundogan refuzoi interesimin nga ish-klubi i tij Borussia Dortmundi dhe një ofertë nga Arabia Saudite.



## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Solar System DPS" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811985889 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Solar System DPS" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811985889 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Solar System DPS" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811985889 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- Drilon Lleshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Lulzim Avdiu, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani"

- Vehbi Ahmeti, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Xheladin Deda"

- Fitore Xhemajli, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Fazli Grajqevci"

- Hysen Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Artiola Batusha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Florjan Hajdaraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl, 10 të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".

- Nahit Shala nga Rogova e Gjakovës shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Virxhina Barbullushi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjmnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

- Muhamet Zherka shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Leon Kuqanaj shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEFCI".

- Albana Peci shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 te shkollës se mesme "Hasan Prishtina".

- "Auto Geti 1" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- Kosovare Imer Hasanaj shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Edukimit në UP "Hasan Prishtina" Prishtinë, Bachelor për shkak të gabimit teknik Kimi -Fizik duhet të jetë Fizik-Kimi me nr. 1243.

- Ilir Sadrijaj nga Gramaçeli, komuna e Deçanit shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" instalues i ujit dhe kanalizimit Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Makinerisë Gjakovë.

- Valon Vala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Irfan Gerbani shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.

- Edin Bicaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Visar Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

- Enver Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIIIshfmu "Fadil Hisari" Prizren.

- CelebicEsef shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- XhelalFerizi shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.

- Valmir Kadrija shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

- Veton Aliu, shpall te pavlefshme dëftesën e 11 klase te shkollës se mesme "ARKITEKT SINANI".

- Bleona Binaku, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "FRANG BARDHI".

- Merlind Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. III të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Remzi Kida nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 11 të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Flamur Godeni nga Gajkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

